REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr.2857 prot. Tiranë, më 25.11.2026

UDHËZIM
Nr. 6, datë 25.11.2026

PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË" NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, nenet 77, 78 dhe 79; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 *"Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"*, i ndryshuar, Kreu I; VKM nr. 824, datë 24.12.2021 *"Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë"*, i ndryshuar; Statutin e UMT-së, nenet 5, 88 dhe 89; Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nenet 69, 70; Rregulloren *"Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave"* e përditësuar; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit nr. 52, datë 3.12.2015 *"Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë"*, i ndryshuar; VSA nr.112, datë 26.10.2023 *"Për përcaktimin e nivelit të gjuhëve të huaja..."*; Vendimet e Senatit Akademik të UMT-së nr. 81-83 datë 31.07.2026 *"Për miratimin e kritereve të pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" dhe të drejtimeve të kërkimit shkencor, për vitin akademik 2026-2027..."*; nr. 84, datë 31.07.2026 *"Për miratimin e kuotave të pranimit, listës së udhëheqësve shkencorë dhe numrat e udhëheqjeve për programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" për vitin akademik 2026-2027, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë"*, si dhe shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 6064/1 prot., datë 21.09.2026 *"Mbi listën e udhëheqësve shkencorë në programet e ciklit të tretë "Doktoratë", për vitin akademik 2026-2027"*,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët aplikojnë në programet e ciklit të tretë Doktoratë, për vitin akademik 2026-2027, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së nr. 84, datë 31.07.2026 *"Për miratimin e kuotave të pranimit, listës së udhëheqësve shkencorë dhe numrat e udhëheqjeve për programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" për vitin akademik 2026-2027, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë"*, nga **data 14-28 dhjetor 2026.**

Procedurat e aplikimit dhe konkurrimit bëhen në përputhje me standardet e cilësisë për programet e studimit të ciklit të tretë Doktoratë dhe Rregulloren *"Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave"* e përditësuar.

2. Njësitë kryesore të UMT-së organizojnë procesin e pranimeve dhe regjistrimit të kandidatëve në programet e ciklit të tretë Doktoratë.

3. Kandidatët që aplikojnë në programet e ciklit të tretë Doktoratë duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe preferenciale miratuar me Vendimet e Senatit Akademik të UMT-së nr. 81, 82 dhe 83, datë 31.07.2026, përkatësisht për Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, për vitin akademik 2026-2027. Për aplikantët që kanë diplomë të barasvlershme sipas sistemit të vjetër, përllogaritja e mesatares së ponderuar bëhet nga komisioni përkatës në njësinë kryesore brenda 3 (tre) ditëve pune nga përfundimi i afatit të aplikimit.

   Nota mesatare e ponderuar (≥8.00), si kriter i përgjithshëm/themelor, referuar vendimeve përkatëse të Senatit Akademik për kriteret, do të konsiderohet si më poshtë:

   a) për kandidatët që zotërojnë diplomë të integruar të ciklit të dytë (Mjekësi, Farmaci, Stomatologji), është nota mesatare e ponderuar në listën e notave;
   b) për kandidatët që zotërojnë diplomë "Bachelor" dhe "Master i Shkencave" në të njëjtën fushë, është nota mesatare e ponderuar e ciklit të parë + nota mesatare e ponderuar e ciklit të dytë / 2;
   c) për diplomat e sistemit të vjetër, nota mesatare e ponderuar e përllogaritur nga komisioni përkatës.

   Nota rrumbullakoset me dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Kandidati paraqitet personalisht, ose një person tjetër i pajisur me prokurë përkatëse prej tij, ose nëpërmjet shërbimit postar, për të dorëzuar dokumentacionin e aplikimit si më poshtë:

   a) Formulari i aplikimit, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën nr. 1:
   b) *Curriculum Vitae* personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, së cilës i bashkëlidhen evidencat e secilit punim, nëse aplikanti ka të tilla;
   c) Kopje të njësuara me origjinalin në RSH të diplomës/ave universitare, listës/ave të notave apo suplementin/et e diplomës/ave. në përmbushje të kritereve të përgjithshme dhe preferenciale sipas programit përkatës të doktoratës, miratuar me Vendim Senati Akademik të UMT-së për vitin akademik 2026-2027. Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes së diplomës në RSH, së bashku me diplomën dhe listën përkatëse të notave. Kopje të njësuar me origjinalin në RSH të diplomave/certifikatave të ciklit të tretë ose të barasvlershme, shoqëruar me listën e notave, nëse kandidati zotëron të tilla.
   d) Kopje të njësuar me origjinalin në RSH të dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaj/a, në një prej 5 gjuhëve të BE-së (Anglisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Frëngjisht), të paktën në nivelin B2. Dëshmitë duhet të jenë të lëshuara nga subjektet me të cilat Ministria përgjegjëse për arsimin ka nënshkruar marrëveshje përkatëse për njohjen dhe ofrimin e testeve të gjuhëve të huaja[1].

[1] Udhëzimi nr. 52, datë 3.12.2015 "*Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë*", i ndryshuar.

e) Projekt-propozimi kërkimor shkencor, në përputhje me drejtimet e kërkimit shkencor të miratuara me VSA nr. 81-83, datë 31.07.2026, ku të evidentohen qartë: objektivat e kërkimit shkencor; metodologjia që do të ndiqet; nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi; platforma/plani i punës kërkimore-shkencore i ndarë në vite; platforma e disertacionit, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore. Projekt-propozimi duhet të jetë i hartuar dhe nënshkruar nga kandidati, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën nr.2.

f) Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;

g) 2 (dy) fotografi;

h) 2 (dy) rekomandime nga personel me titull akademik në fushën e shëndetit, që njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit, lidhur me këtë aplikim, të lëshuar brenda 3 muajve të fundit;

i) Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar, që dëshmon se aplikanti është personel akademik ose personel i përfshirë në kërkim shkencor;

j) Deklaratë e një prej udhëheqësve shkencorë të miratuar në programin përkatës të studimit, se projekti i kërkimit shkencor të propozuar nga kandidati është i përshtatshëm për aplikimin për studime të doktoratës në këtë program, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën nr.3. Një udhëheqës shkencor mund të lëshojë më shumë se një deklaratë udhëheqjeje;

k) Deklaratë e aplikantit, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën nr. 4, që:
   - nuk ka patur në të kaluarën masa disiplinore, shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës apo shkelje të kodit deontologjik profesional, si dhe që do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
   - nuk është duke ndjekur një program tjetër studimi;
   - pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, në rastet e vetëfinancimit;

l) Mandat pagesa për tarifën e aplikimit prej 5000 (pesëmijë) lekë (Vendimi Nr. 67, datë 02.11.2023 i Bordit të Administrimit të UMT-së).

Dokumentacioni duhet të jetë i inventarizuar sipas numrit të dokumenteve dhe faqeve përkatëse. Lista e inventarit mbahet në dy kopje, një prej të cilave shoqëron dosjen dhe kopja tjetër i jepet kandidatit.

5. Njësitë kryesore, bëjnë publikimin e kritereve, procedurave dhe afateve për aplikimin në kuadër të pranimit në programet e studimit të doktoratës, në faqet e tyre zyrtare (web), të paktën 1 (një) muaj përpara përfundimit të afatit të aplikimit. Kriteret, procedurat dhe afatet për aplikim publikohen edhe në faqen zyrtare të UMT-së.

6. Njoftimi publik në faqen zyrtare të çdo njësie kryesore dhe të UMT-së, duhet të përmbajë:
   - Udhëzimin nr. 6, datë 25.11.2026 të Rektorit të UMT-së "*Për procedurat e aplikimit dhe pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027*", si dhe shtojcat përkatëse;
   - Kriteret e pranimit (të përgjithshme dhe preferenciale) dhe drejtimet e kërkimit shkencor sipas programeve të studimit Doktoratë, miratuar me vendimin përkatës të Senatit Akademik

të UMT-së të datës 31.07.2026 *"Për miratimin e kritereve të pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" dhe të drejtimeve të kërkimit shkencor, për vitin akademik 2026-2027..."*, sipas njësisë kryesore;

- Listën e udhëheqësve shkencorë dhe numrat e udhëheqjeve, sipas programeve të studimit Doktoratë dhe sipas njësive kryesore të UMT-së, miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së nr. 84, datë 31.07.2026 *"Për miratimin e kuotave të pranimit, listës së udhëheqësve shkencorë dhe numrat e udhëheqjeve për programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" për vitin akademik 2026-2027, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë"*;
- Rregulloren "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave" e përditësuar;

7. Kandidatët të cilët aplikojnë në një program studimi të ciklit të tretë "Doktoratë" në UMT, dorëzojnë aplikimet e tyre në zyrën e protokoll arkivës të njësisë kryesore përkatëse. Në rastin e aplikimit përmes shërbimit postar, data në vulën e shërbimit postar do të shërbejë për të përcaktuar respektimin e afateve të aplikimit.

8. Njësia kryesore përcjell listën e kandidatëve që kanë aplikuar në programet e doktoratës në Rektoratin e UMT brenda 1 (një) dite pune nga përfundimi i afatit të aplikimit dhe bën publike listën e aplikantëve (*të anonimizuar me ID përkatëse*). Brenda 1 (një) jave nga përfundimi i datës së aplikimeve **(deri më datë 6 janar 2027),** njësia kryesore i përcjell njësisë bazë përkatëse dosjet e aplikimeve të kandidatëve për programet e doktoratës.

9. Komisionet *ad hoc* të vlerësimit ngrihen me vendim të Dekanatit jo më vonë se 1 (një) javë para datës së përfundimit të aplikimeve dhe përbëhen nga të gjithë anëtarët e njësisë bazë, që mbajnë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" dhe drejtohen nga përgjegjësi i njësisë bazë. Në rastet e programeve me nënfusha specifike, dekanati mund të ngrejë komisione *ad hoc* sipas nënfushave, përbërja e të cilëve është nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Përbërja e komisioneve i njoftohet Rektoratit jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga ngritja e tyre. Në rastet kur njësitë bazë bashkëpunojnë për organizimin e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, komisioni *ad hoc* mund të ngrihet në nivel njësie kryesore. Pas njohjes me listat e aplikantëve, anëtarët e Komisioneve *ad hoc* nënshkruajnë deklaratën për shmangien e konfliktit të interesit sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën nr. 5. Anëtari që ndodhet në konflikt interesi me një aplikant sipas legjislacionit përkatës heq dorë nga vlerësimi i atij aplikanti dhe kjo pasqyrohet në procesverbal.

10. Përparësi në përzgjedhjen e kandidatëve, në programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në UMT, ka personeli akademik me kohë të plotë në UMT; personeli akademik me kohë të pjesshme në UMT; kandidatët e tjerë të punësuar si personel akademik në institucionet e tjera publike dhe jopublike të arsimit të lartë, apo personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit "universitet" ose "akademi" në RSH.

11. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e dosjeve. Komisioni ad hoc, verifikon përmbushjen e kritereve të përgjithshme/themelore, dhe më pas bën renditjen e kandidatëve, sipas fushave/nënfushave të programeve të studimit të doktoratës, mbështetur në dokumentacionin në dosjen përkatëse të aplikantit.

    Në vlerësimin e kandidatëve, merren në konsideratë kriteret e miratuara, sipas raporteve në vijim:

a)	Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të dytë[2]	20 pikë
b)	Projekt propozimi për kërkimin shkencor	30 pikë
c)	Eksperienca në mësimdhënie	10 pikë
d)	Veprimtaria botuese, pjesëmarrja në projekte kërkimore	10 pikë
e)	Eksperienca profesionale	10 pikë
f)	Kualifikime shkencore/profesionale (specializim, master ekzekutiv, trajnim mbi 6 muaj pa ndërprerje)	10 pikë
g)	Kritere të tjera preferenciale të vendosura nga njësia bazë/njësitë bazë	10 pikë

12. Komisioni ad hoc bën vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve në rend zbritës, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në Shtojcën nr. 6. Lista paraprake e renditur miratohet në mbledhjen e njësisë bazë. Brenda 1 (një) dite pune nga miratimi, njësia bazë ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore listën paraprake të anonimizuar me ID përkatëse, tabelën e vlerësimit të detajuar të aplikantëve (Shtojca nr. 6) dhe procesverbalin e mbledhjes. Drejtuesi i njësisë kryesore ia përcjell të gjithë dokumentacionin Rektoratit të UMT-së dhe brenda 1 (një) dite pune nga marrja e tij, publikon listën paraprake të anonimizuar në faqen zyrtare të njësisë kryesore.

13. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit, brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të renditur. Ankimimi bëhet pranë zyrës së protokollit të njësisë kryesore dhe i përcillet menjëherë komisionit ad hoc përkatës. Komisionet ad hoc brenda 2 (dy) ditëve pune shqyrtojnë ankimimet dhe marrin vendimin përkatës. Vendimi i përcillet Dekanit, i cili njofton me shkrim ankimuesin brenda 1 (një) dite pune.
14. Pas përfundimit të procesit të ankimimit, Komisioni *ad hoc* vendos përfundimisht udhëheqësit shkencorë sipas renditjes së kandidatëve dhe projekt propozimeve të kërkimit shkencor. Nëse e vlerëson, në këtë mbledhje Komisioni mund të ftojë edhe kandidatët fitues të programit.

15. Lista e kandidatëve fitues, e udhëheqësve shkencorë përkatës dhe projekteve kërkimore fituese, përcillet për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore, shoqëruar me një relacion shpjegues për punën e kryer, sipas çdo fushe/nënfushe.

16. Drejtuesi i njësisë kryesore shqyrton dokumentacionin dhe procedurat e kryera dhe pas miratimit e përcjell praktikën e plotë në Rektoratin e UMT-së. Pas miratimit nga Rektori i UMT-së, lista e kandidatëve fitues, e udhëheqësve shkencorë përkatës dhe projekteve kërkimore fituese përcillet për publikim tek drejtuesi i njësisë kryesore.

17. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 1 (një) ditë pune, pas miratimit nga Rektori i UMT-së, publikon listën e kandidatëve fitues *(e anonimizuar me ID përkatëse)*.

18. Rektorati i UMT-së gëzon të drejtën e monitorimit të procesit të aplikimit dhe shpalljes së fituesve në këto programe studimi.

19. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga publikimi i listës përfundimtare kryhet regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarisë përkatëse, nënshkrimi i projektit përfundimtar fitues nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor sipas modelit në Shtojcën nr. 7. si dhe nënshkrimi i kontratës tip midis kandidatit fitues dhe përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie

[2] sipas pikës 3 të këtij udhëzimi

kryesore. Brenda 3 ditëve pune, njësitë kryesore përcjellin në Rektoratin e UMT kopje të kontratave të nënshkruara.

20. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga përfundimi i regjistrimit të kandidatëve fitues, njësia kryesore përcjell në UMT, të dhënat e doktorantëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike, sipas modelit në Shtojcën nr. 8, si dhe kopje të diplomave paraardhëse dhe të dëshmisë së gjuhës së huaj (të skanuara), me qëllim pajisjen me numër matrikullimi të doktorantëve.
21. Brenda 2 (dy) muajve nga data e regjistrimit, doktorantët duhet të kërkojnë miratim nga Këshilli i Etikës të UMT-së për projektin e tyre kërkimor.
22. Dispozita të fundit
    a) Për të gjitha çështjet të cilat nuk trajtohen në këtë Udhëzim, do të zbatohen dispozitat e Rregullores *"Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave", e përditësuar, dhe legjislacioni në fuqi.*
    b) Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës në Rektoratin e UMT-së.
    c) Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI

Shtojca nr. 1

FORMULAR APLIKIMI

për pranim në programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"

Unë i/e nënshkruari/a: _____

(Emri, atësia, mbiemri)

Datëlindja _____ Vendlindja _____

Vendbanimi/Adresa _____

nr. personal identifikimi (ID) _____

Cel _____ E-mail _____

Paraqes aplikimin për pranim në programin e ciklit të tretë të doktoratës në:

Programin (fusha/nënfusha) _____

Drejtimi i kërkimit shkencor _____

Tema e Projekt-Propozimit _____

Kërkimor Shkencor _____

_____

_____

Departamenti[1] _____

Fakulteti _____

Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese, nën përgjegjësinë time ligjore,

DEKLAROJ se:

1. Zotëroj (shëno me ☒ diplomën/at përkatëse):

Lloji i diplomës	Në (fusha / programi)	Lëshuar nga IAL	E njohur në RSH*
☐ Diplomë e Integruar e Ciklit të Dytë "Master i Shkencave"			☐
☐ Diplomë e Ciklit të Parë Bachelor + Ciklit të Dytë "Master i Shkencave"			☐
☐ Diplomë sipas sistemit të vjetër të barasvlershme (Master i Shkencave)			☐

** Plotësohet vetëm për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë*

2. Kam notë mesatare të ponderuar si më poshtë (me dy shifra pas presjes dhjetore):

☐ Diplomë e integruar e ciklit të dytë: nota mesatare e ponderuar _____

☐ Bachelor + Master i Shkencave: (nota mesatare e ponderuar e ciklit të parë _____ + nota mesatare ponderuar e ciklit të dytë _____) / 2 = _____

☐ Diplomë e sistemit të vjetër: nota mesatare aritmetike[2] _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË - REKTORATI - SEKRETARIA

---

[1] *Nëse programi i doktoratës ofrohet nga më shumë se një departament, të mos vendoset.*

[2] *Nota mesatare e ponderuar për diplomat e sistemit të vjetër llogaritet nga komisioni përkatës i njësisë kryesore*

3. Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë (shëno nivelin për secilën, sipas dwshmisw lwshuar nga subjektet e njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin)

☐ Angleze _____ ☐ Italiane _____

☐ Frënge _____ ☐ Gjermane _____

☐ Spanjolle _____

4. Autorizoj Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve të doktoratës, si dhe publikimin eventual të tyre.
5. Autorizoj Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA, si dhe institucionet që kanë lëshuar diplomat dhe certifikatat e paraqitura për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare apo periudhën e studimeve të kryera më parë, si dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me dokumentacionin e dorëzuar në kuadër të këtij aplikimi.
6. Deklaroj se jam njohur me Rregulloren për organizimin e programeve të studimit të doktoratave, e përditësuar (miratuar me VSA nr. 58, datë 27.06.2022, e ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr. 6 , datë 25.11.2026 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe jam i/e qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar dhe vendimin përkatës për kriteret të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (VSA nr. 81, 82 ose 83, datë 31.07.2026).
7. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i/e vetëdijshëm/e se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe QSHA nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve ligjore kompetente.

Bashkëlidh dokumentet e kërkuara në pikën 4 të Udhëzimit nr. 6, datë 25.11.2026 i Rektorit të UMT-së, të inventarizuara sipas numrit të dokumenteve dhe faqeve; një kopje e listës së inventarit më kthehet mua.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · REKTORATI · SEKRETARIA · UNIVERSITETI I MJEKËSISË · TIRANË

Tiranë më: _____ / _____ / _____

Emër Atësi Mbiemër
i kandidatit — Firma

Emër Mbiemër
i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit — Firma

Shtojca nr.2

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Njësia kryesore: _____ Njësia bazë: _____

PROJEKT-PROPOZIM I KËRKIMIT SHKENCOR

për aplikim në programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" – viti akademik 2026-2027

Njësia kryesore	☐ *Fakulteti i Mjekësisë (FM)* ☐ *Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD)* ☐ *Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT)*
Njësia bazë (departamenti) përgjegjëse[1]	
Programi i doktoratës	*Emërtimi i programit, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 81 / 82 / 83, datë 31.07.2026*
ID e aplikantit	

BAZA RREGULLATIVE

- Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*;
- VKM nr. 112, datë 23.02.2018 *"Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" ..."*, i ndryshuar;
- VKM nr. 824, datë 24.12.2021 *"Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë"* , i ndryshuar, Shtojca nr. 6 *"Standardet e cilësisë për programet e ciklit të tretë "Doktoratë"*;
- VKM nr. 777, datë 26.12.2018 *"Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"*, i ndryshuar;
- Statuti i UMT-së dhe Rregullorja e UMT-së
- Rregullorja *"Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave"*, e përditësuar
- Rregullorja e Këshillit të Etikës së UMT-së dhe Kodi i Etikës i UMT-së;
- Udhëzimi i Rektorit nr. 6, datë 25.11.2026 *"Për procedurat e aplikimit dhe pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" ... për vitin akademik 2026-2027"* (në vijim: Udhëzimi).

UDHËZIME PËR PLOTËSIM

Projekt-propozimi vlerësohet nga Komisioni ad hoc me deri në 30 pikë. Ai hartohet dhe nënshkruhet nga kandidati, në gjuhën shqipe, Times New Roman 12, hapësirë 1.15, jo më shumë se 10 faqe A4 (pa referencat). Tema duhet të jetë brenda fushave/drejtimeve të kërkimit të miratuara nga njësia bazë dhe të lidhet me drejtimin kërkimor të një udhëheqësi të miratuar me VSA nr. 84, datë 31.07.2026.

Tekstet me shkrim kursiv gri , janë udhëzuese dhe fshihen gjatë plotësimit.

SEKSIONI 1 • TË DHËNAT E KANDIDATIT

Emër, atësi, mbiemër	
Datëlindja	*dd mm vvvv*
Email / telefon	
Diploma e ciklit të dytë[2]	*Programi, institucioni, viti, nota mesatare e ponderuar*
Specializim / kualifikime të tjera	*Nëse ka (specializim afatgjatë, master ekzekutiv, trajnim mbi 6 muaj)*
Pozicioni aktual i punës	*Institucioni, pozicioni: ☐ personel akademik me kohë të plotë në UMT ☐ me kohë të pjesshme në UMT ☐ personel akademik/kërkimor në IAL tjetër ☐ tjetër*
ORCID / Google Scholar	*Nëse ka*

[1] *Nëse programi i doktoratës ofrohet nga më shumë se një departament, të mos vendoset.*
[2] *Sipas pikës 3 të Udhëzimit nr. 6, datë 25.11.2026.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · REKTORATI · SEKRETARIA · UNIVERSITETI I MJEKËSISË · TIRANË

SEKSIONI 2 • IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

Titulli i propozuar i projektit	*Titull i qartë dhe specifik (shqip dhe anglisht)*
Drejtimi kërkimor	*Sipas drejtimeve të kërkimit shkencor të miratuara me VSA nr. 81 / 82 / 83, datë 31.07.2026*
Udhëheqësi shkencor mbështetës	*Emër, mbiemër, titulli akademik (nga lista e miratuar me VSA nr. 84, datë 31.07.2026), i cili/të cilët kanë dhënë mbështetje për aplikantin.*
Fjalë kyçe	*3–6 fjalë kyçe*
Kohëzgjatja e parashikuar	☐ *3 vite* ☐ *4 vite* ☐ *5 vite*

SEKSIONI 3 • PËRMBAJTJA SHKENCORE E PROPOZIMIT

3.1 Përmbledhje (abstrakt)

Maksimumi 250 fjalë: problemi, qëllimi, metodologjia në pak fjalë, rezultatet dhe risia e pritshme.

3.2 Sfondi, gjendja e njohurive dhe nevoja për studim të thelluar

Rishikim i shkurtër kritik i literaturës: çfarë dihet dhe çfarë mungon (boshllëku shkencor); pse ky studim është i nevojshëm për fushën dhe për vendin. Maksimumi 800 fjalë.

3.3 Problemi kërkimor, pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Formuloni qartë problemin; 2–4 pyetje kërkimore; hipotezat (kur aplikohen).

3.4 Qëllimi dhe objektivat e kërkimit shkencor

Qëllimi i përgjithshëm (1–2 fjali) dhe objektivat specifikë, të matshëm dhe të realizueshëm brenda kohëzgjatjes së programit.

3.5 Metodologjia që do të ndiqet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË - REKTORATI - SEKRETARIA

Dizajni i studimit; popullata/mostra dhe llogaritja e madhësisë së saj; kriteret e përfshirjes/përjashtimit; metodat, instrumentet, teknikat laboratorike/klinike/teknologjike; mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave; analiza statistikore; vendi ku do të realizohet kërkimi; kufizimet e mundshme dhe mënyra e menaxhimit të tyre.

3.6 Risia dhe kontributi i pritshëm i punimit

Çfarë sjell e re studimi në nivel shkencor, klinik/profesional, shoqëror; lidhja me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, Strategjia për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, prioritetet e OBSH-së, SDG).

3.7 Aspektet etike

Identifikoni çështjet etike (subjekte njerëzore, të dhëna personale, kafshë laboratorike, materiale biologjike) dhe mënyrën e trajtimit; konfirmoni se projekti do t'i paraqitet Këshillit të Etikës së UMT-së brenda 2 muajve nga regjistrimi.

3.8 Rreziqet kryesore dhe zgjidhjet alternative

Identifikoni 2–3 rreziqe që mund të vonojnë projektin (p.sh. numri i synuar i pacientëve, aksesi në pajisje, financimi) dhe masat alternative për secilin.

3.9 Përshtatshmëria e kandidatit për projektin

Shpjegoni shkurt si e dëshmon projekti mendimin krijues, sensin kritik për zhvillimin e fushës, lidhjet ndërmjet fushave të kërkimit, aftësinë për zgjidhjen e problemeve dhe për menaxhimin e kompleksitetit të kërkimit; përvoja juaj e mëparshme e lidhur me temën. Maksimumi 300 fjalë.

SEKSIONI 4 • PLATFORMA E DISERTACIONIT

Paraqitni strukturën e parashikuar të disertacionit (kapitujt kryesorë dhe përmbajtjen e shkurtër të secilit). Struktura është orientuese dhe mund të përditësohet në projektin përfundimtar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - REKTORATI - UNIVERSITETI I TIRANËS - SEKSIONI I ARKIVËS

Nr.	Kapitulli	Përmbajtja e shkurtër
1	Hyrje	
2	Rishikimi i literaturës	
3	Qëllimi, objektivat, hipotezat	
4	Materiali dhe metodat	
5	Rezultatet	
6	Diskutimi	
7	Përfundime dhe rekomandime	
	Bibliografia; Shtojcat	

SEKSIONI 5 • PLANI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE I NDARË NË VITE

Plani duhet të përfshijë edhe realizimin e detyrimeve të nenit 8 të Rregullores së doktoratave, i përditësuar, në zbatim të VKM nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, Kreu I, pika 6 (3 referime/paraqitje shkencore dhe 3 artikuj shkencorë para paraqitjes për mbrojtje). Kohëzgjatja normale është 3 deri 5 vite akademike

Viti / periudha	Aktivitetet kryesore kërkimore dhe formuese	Rezultati / produkti i pritshëm (milestone)	Afati
Viti I	*p.sh. rishikim sistematik i literaturës; finalizim i protokollit; aplikim në Këshillin e Etikës të UMT-së; p.sh. studim pilot; validim instrumentesh; fillim i mbledhjes së të dhënave*		
Viti II	*p.sh. mbledhja kryesore e të dhënave / eksperimentet; analiza paraprake; referim i parë shkencor*		
Viti III	*p.sh. analiza përfundimtare; botime; hartimi i disertacionit; paraqitja në njësinë bazë*		
Viti IV–V (nëse aplikohet)	*Vetem nese planifikohet kohëzgjatje mbi 3 vite (max 5 vite, jo me shume se 15)*		

SEKSIONI 6 • BURIMET, INFRASTRUKTURA DHE FINANCIMI

Infrastruktura kërkimore që do të përdoret	*Laboratorë, pajisje, shërbime klinike, baza të dhënash, në njësinë bazë kryesore ose te partnerët. Për kërkime laboratorike, baza laboratorike duhet të sigurohet për së paku 6 muaj*
Institucione bashkëpunuese	*Nëse ka: natyra e bashkëpunimit dhe statusi i marrëveshjes*
Mundësia e mbulimit nga grante kërkimore-shkencore	*Grante projekte ekzistuese ose të mundshme (AKKSHI, Horizon Europe, të tjera) ku mund të integrohet studimi*
Burimi kryesor i financimit	☐ *Projekt grant kërkimor* ☐ *Vetëfinancim*
Kostot kryesore të parashikuara	*Orientuese: materiale/reagentë, analiza, pajisje, pjesëmarrje në konferenca, botime*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · REKTORATI · UNIVERSITETI MJEKËSISË · TIRANË

SEKSIONI 7 • REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

Listoni 15–30 referencat kryesore mbi të cilat bazohet projekt- propozimi.

1. _____

2. _____

SEKSIONI 8 • DEKLARATË DHE NËNSHKRIM I KANDIDATIT

Unë, i/e nënshkruari/a _____, deklaroj nën përgjegjësinë time se ky projekt-propozim është punë origjinale e imja, se burimet e përdorura janë cituar sipas rregullave dhe se do të zbatoj standardet shkencore dhe etike të kërkimit, në përputhje me nenin 6, pika 1, germat g) dhe h) dhe nenin 25 të Rregullores, me Kodin e Etikës të UMT-së dhe me VKM nr. 773, datë 26.12.2018, i ndryshuar, për kontrollin antiplagjiaturë.

Kandidati

Hartoi dhe nënshkroi projekt-propozimin

_____

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Tiranë më: ___ / ___ / 2026

Shtojca nr. 3

Tiranë më ___.___.2026

DEKLARATË E UDHËHEQËSIT SHKENCOR

për përshtatshmërinë e projekt-propozimit kërkimor shkencor të kandidatit për pranim në programin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", viti akademik 2026-2027

Unë, i/e nënshkruari/a: _____

Titulli akademik: ☐ Profesor ☐ Profesor i Asociuar

Statusi: ☐ Personel akademik me kohë të plotë ☐ Personel akademik me kohë të pjesshme

Departamenti: _____

Fakulteti: _____Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në cilësinë e udhëheqësit shkencor të miratuar në programin përkatës të studimit të doktoratës, sipas Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së nr. 84, datë 31.07.2026 *"Për miratimin e kuotave të pranimit, listës së udhëheqësve shkencorë dhe numrat e udhëheqjeve për programet e ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë, për vitin akademik 2026-2027, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"*, **deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:**

Kam shqyrtuar projekt-propozimin kërkimor shkencor i cili përputhet me fushën time të ekspertizës shkencore, paraqitur nga kandidati:

(Emri, atësia, mbiemri i kandidatit): _____

Tema e projekt-propozimit kërkimor shkencor: _____

_____

_____

dhe vlerësoj se ky projekt propozim është i përshtatshëm për aplikim në:

Programi i doktoratës (fusha/nënfusha): _____

Drejtimi i kërkimit shkencor: _____

Deklaroj gjithashtu se:

- projekti mund të realizohet me infrastrukturën dhe burimet e njësisë bazë ose të institucioneve bashkëpunuese;
- jam në dijeni se kjo deklaratë nuk garanton pranimin e kandidatit dhe se udhëheqësi caktohet përfundimisht nga komisioni ad hoc, sipas renditjes.

Kjo deklaratë nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë.

Udhëheqësi shkencor

_____

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - REKTORATI - SEKRETARIA - UNIVERSITETI MJEKËSISË - TIRANË

Shtojca nr. 4

Tiranë më ___.___.2026

DEKLARATË E APLIKANTIT

Unë i/e nënshkruari/a _____

me nr. personal identifikimi (ID) _____

aplikant/e në programin e studimit të doktoratës në fushën/nënfushën:

_____,

Departamenti[1] i _____,

Fakulteti i _____, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë,

deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

1. Nuk jam duke ndjekur ndonjë program tjetër studimi dhe në rast pranimi, nuk do të regjistrohem njëkohësisht në një program tjetër studimi.
2. Nuk janë marrë masa disiplinore ndaj meje dhe nuk kam kryer në të kaluarën shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe shkelje të kodit deontologjik profesional.
3. Do të zbatoj standardet shkencore dhe etike gjatë kërkimit shkencor në programin e studimit të doktoratës, sipas Kodit të Etikës të UMT-së.
4. Do të paguaj detyrimet financiare në programin e studimeve të doktoratës, në rastet e vetëfinancimit, sipas tarifave të miratuara nga Bordi i Administrimit të UMT-së.

Kjo deklaratë nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë.

Aplikanti

_____

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

[1] *Nëse programi i studimit ofrohet nga më shumë se një departament, të mos vendoset.*

Shtojca nr. 5

DEKLARATË PËR SHMANGIEN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Unë, i/e nënshkruari/a ....., në cilësinë e anëtarit të Komisionit *Ad Hoc* për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë për pranim në programin e ciklit të tretë të studimeve:

Doktoratë në .....,

në Departamentin[1] .....,

në Fakultetin e ....., në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se:

❑ **NUK NDODHEM në kushtet e konfliktit të interesit**, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 23/2026, datë 03.02.2026, "*Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike*", në lidhje me kandidatët dhe procedurat e vlerësimit për të cilat jam ngarkuar si anëtar i këtij Komisioni.

❑ **NDODHEM** në konflikt interesi (real, të mundshëm ose të perceptuar) me aplikantin me ID _____ dhe heq dorë nga vlerësimi dhe pikëzimi i tij/saj.

Angazhohem që, nëse gjatë procedurës lind një konflikt interesi, ta deklaroj menjëherë me shkrim dhe të tërhiqem nga vlerësimi i atij aplikanti, si dhe të ruaj konfidencialitetin e të dhënave të aplikantëve.

Kjo deklaratë nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë.

Deklaruesi ..... Tiranë më ___. ___ .2026

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

[1] *Në rastin kur është një komision nuk vihet departamenti.*

Shtojca nr. 6

Nr. i udhëheqjeve në program: x

Tabela e vlerësimit të aplikantëve në programin e ciklit të tretë të studimit: Doktoratë në _____,
Departamenti_____, Fakulteti i _____

Viti akademik 2026-2027

Nr.	Emër	Mbiemër	ID e aplikantit	Fusha e diplomës/ve bazë	Fusha e diplomës bazë është në fushën e kërkuar nga programi, sipas VSA nr. 81–83, datë 31.07.2026? Po/Jo	Lloji i diplomës (Integruar / Bachelor + Master / Sistem i vjetër)	Nota mesatare e ponderuar sipas diplomës	Gjuha e huaj, testi/dëshmia dhe subjekti që e ka lëshuar	Niveli i gjuhës (A1–C2; minimumi B2)	Plotëson kriteret themelore Po/Jo	Pikët për notën mesatare të ponderuar (0–20 pikë)	Emërtimi i projekt propozimit kërkimor shkencor	Pikët për projekt propozimin kërkimor shkencor (30 pikë)	Vitet e eksperiencës në mësimdhënie, lënda/programi	Pikët për eksperiencë në mësimdhënie (10 pikë)	Veprimtaria botuese, pjesëmarrje në projekte kërkimore	Pikët për veprimtarinë botuese, pjesëmarrjen në projekte kërkimore (10 pikë)	Vitet e eksperiencës profesionale, vendi i punës	Pikët për eksperiencën profesionale (10 pikë)	Kualifikimet shkencore/profesionale (specializim, master ekzekutiv, trajnim mbi 6 muaj pa ndërprerje)	Pikët për kualifikimet shkencore/profesionale (specializim, master ekzekutiv, trajnim mbi 6 muaj pa ndërprerje) (10 pikë)	Cilat nga kriteret preferenciale te miratuara sipas VSA perkatese plotëson kandidati	Pikët për kritere të tjera preferenciale te miratuara sipas VSA perkatese (10 pikë)	PIKËT TOTALE	Renditja (vetëm kandidatët me "Po" te kriteret themelore)	Statusi (Fitues / Jo fitues/I skualifikuar)	Udhëheqësi Shkencor Mbështetës
1																										
2																										
3																										
4																										

* Kriteret e tjera preferenciale të miratuara mw VSA pwrkatwse

1

2....

Shënime:

a) Nota mesatare e ponderuar: diplomë e integruar e ciklit të dytë; Bachelor + Master i Shkencave /2; sistem i vjetër = NMP përllogaritet nga komisioni i njësisë kryesore.

b) Pikët për notën: (nota – 5) × 4, me dy shifra pas presjes; nota 5 = 0 pikë, nota 10 = 20 pikë.

c) Kandidati skualifikohet dhe nuk pikëzohet (kolona K = Jo): nëse nota < 8.00, gjuha e huaj nën B2, fusha e diplomës jo në fushën e kërkuar ose kur nuk plotëson kriteret e tjera themelore . Statusi I aplikantit shënohet "Skualifikuar".

d) Lista miratohet në mbledhjen e njësisë bazë, procesverbali nr. ____, datë ___.___.2026, dhe publikohet vetëm me ID (fleta "Lista për publikim").

Komi Data: ___.___.2026

1 Emër Mbiemër, Firmë

2

...

Shtojca nr. 7

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Njësia kryesore: _____ Njësia bazë: _____

PROJEKTI PËRFUNDIMTAR I KËRKIMIT SHKENCOR TË DOKTORATËS

nënshkruar nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor në momentin e regjistrimit , për dijeni drejtuesi dhe koordinatori i programit

Njësia kryesore	☐ *Fakulteti i Mjekësisë (FM)* ☐ *Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD)* ☐ *Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT)*
Njësia bazë (departamenti) përgjegjëse	
Programi i doktoratës	*Emërtimi i programit, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 81 / 82 / 83, datë 31.07.2026*
Akti i shpalljes fitues	*Miratimi i Rektorit nr. ___, datë ___.___.20___ për listën e fituesve, udhëheqësve dhe projekteve fituese*
Data e regjistrimit /NIM	___.___.20___ *(referuar datës së nënshkrimit të kontratës)* / *NIM:* _____ *(plotësohet nga sekretaria pas pajisjes me NIM nga QSHA)*

Ky dokument nënshkruhet nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor brenda 10 ditëve nga publikimi i listës përfundimtare, njëkohësisht me regjistrimin dhe kontratën tip. Ai përbën programin e miratuar të kërkimit që doktoranti ka detyrë ta përmbushë dhe bazën për monitorimin e ecurisë së doktorantit.

Projekti përfundimtar ndërtohet mbi projekt-propozimin fitues të kandidatit. Të dhënat e udhëheqësit shkencor plotësohen drejtpërdrejt në këtë dokument (seksionet 2 dhe 5), njëlloj për të tre njësitë kryesore. Ndryshimi i temës dhe i udhëheqësit bëhet sipas rregullores për organizimin e doktoratave, në fuqi.

SEKSIONI 1 • TË DHËNAT E DOKTORANTIT

Emër, atësi, mbiemër	
Datëlindja	*dd / mm / vvvv*
Email / telefon	
Diploma e ciklit të dytë	*Programi, institucioni, viti*
Pozicioni aktual i punës	*Institucioni, pozicioni, statusi (kohë e plotë / e pjesshme)*
Forma e financimit	☐ *Projekt grant kërkimor* ☐ *Vetëfinancim*

SEKSIONI 2 • TË DHËNAT E UDHËHEQËSIT SHKENCOR

Plotësohet nga udhëheqësi shkencor dhe pasqyron gjendjen në datën e nënshkrimit. Udhëheqësi bashkëlidh CV-në akademike (Europass) me listën e publikimeve.

2.1 Të dhëna personale dhe akademike

Emër, mbiemër	
Titulli akademik	☐ *Profesor* ☐ *Profesor i Asociuar*
Viti i marrjes së titullit	*"Profesor i Asociuar":* _____ *"Profesor":* _____ *(ose N/A)*
Grada "Doktor"/PhD	*Viti; institucioni dhe shteti; tema e disertacionit*

Njësia kryesore / njësia bazë	
Pozicioni aktual	*p.sh. personel akademik, përgjegjës departamenti, mjek pranë…*
Statusi i punësimit	*☐ Kohë e plotë ☐ Kohë e pjesshme*
Email institucional / telefon	
ORCID ID / Google Scholar	*https://orcid.org/0000-… / link*
Miratimi si udhëheqës	*VSA nr. 84, datë 31.07.2026 dhe shkresa e Ministrisë nr. ___, datë ___ — tema/drejtimi i miratuar: _____*

2.2 Profili kërkimor dhe kapaciteti udhëheqës

Fusha e përgjithshme e ekspertizës	
Nënfusha / drejtimi specifik i kërkimit	
Doktorantë të udhëhequr (përfunduar)	*Numri total / N/A*
Doktorantë aktualisht në udhëheqje/bashkudhëheqje	*Numri, në UMT dhe në çdo IAL tjetër, përfshirë dhe këtë doktorant: ____*
Verifikimi i kufirit ligjor	*☐ Brenda kufirit: "Profesor" ≤ 3; "Profesor i Asociuar" ≤ 2 doktorantë njëkohësisht, në të gjitha IAL*

2.3 Veprimtaria shkencore e lidhur me fushën e projektit (pas titullit të fundit akademik)

Udhëheqësi është pjesë aktive e veprimtarive kërkimore dhe botuese dhe e përfshin doktorantin në to.

Nr.	Veprimtaria	Numri
1	Artikuj të indeksuar	Autor i parë nr. ___ / bashkautor nr. ___ Autor i fundit *(Senior author)* _____
2	Konferenca (ISBN/ISSN)	Prezantues oral nr. ___ / poster autor i parë nr. ___
3	Projekte kërkimore	Drejtues nr. ___ / anëtar nr. ___

SEKSIONI 3 • IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

Titulli përfundimtar i projektit / disertacionit	*Shqip dhe anglisht*
Fusha / nënfusha e kërkimit	*Sipas fushave të miratuara nga njësia bazë (VSA përkatëse)*
Tema/drejtimi i udhëheqësit më të cilin integrohet	*Tema/drejtimi kërkimor i miratuar për udhëheqësin me VSA nr. 84, datë 31.07.2026*
Fjalë kyçe	*3–6 fjalë kyçe*
Kohëzgjatja e planifikuar	*☐ 3 ☐ 4 ☐ 5 vite akademike, duke filluar nga data e nesërme e nënshkrimit të kontratës*
Ndryshime nga projekt-propozimit fitues	*☐ Asnjë ☐ Po — përshkruani shkurt ndryshimet dhe arsyen (p.sh. sugjerime të Komisionit ad hoc)*

SEKSIONI 4 • PËRMBAJTJA SHKENCORE E PROJEKTIT

4.1 Përmbledhje (abstrakt)

Maksimumi 250 fjalë, shqip dhe anglisht, e strukturuar sipas katër rubrikave të mëposhtme: Hyrja, Qëllimi, Metodologjia, Rezultatet e Pritshme / Impakti i studimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · MINISTRIA E ARSIMIT · UNIVERSITETI I TIRANË · REKTORATI · SEKRETARIA

4.2 Argumentimi i nevojës për studim

Gjendja e njohurive, boshllëku shkencor dhe rëndësia e studimit.

4.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

4.4 Qëllimi dhe objektivat specifikë

Objektiva të matshëm; secili objektiv lidhet me një ose më shumë kapituj të disertacionit dhe me planin e punës (seksioni 6).

4.5 Metodologjia

Popullata/mostra; metodat dhe instrumentet; mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave; analiza statistikore; vendi i kërkimit; kufizimet.

4.6 Risia, rezultatet e pritshme dhe impakti

Kontributi shkencor, klinik/profesional dhe shoqëror; lidhja me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare.

SEKSIONI 5 • KUADRI KËRKIMOR I UDHËHEQËSIT DHE BURIMET

Plotësohet nga udhëheqësi shkencor. Studimet e doktoratës zhvillohen si pjesë e një projekti kërkimor të aprovuar dhe me financim të siguruar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË · REKTORATI · SEKRETARIA

5.1 Projekte kërkimore ku integrohet doktorata (nëse ka)

Nr.	Titulli i projektit	Statusi	Burimi i financimit	Roli i doktorantit / lidhja me projektin
1				
2				

Mënyra e realizimit	*☐ Brenda njësisë ☐ Në bashkëpunim me institucione të tjera*
Institucionet partnere dhe marrëveshjet	*Emri, natyra e bashkëpunimit; ☐ marrëveshje e nënshkruar ☐ në proces ☐ N/A*
Infrastruktura kërkimore e vënë në dispozicion	*Laboratorë, pajisje, akses klinik, baza të dhënash; për kërkime laboratorike, së paku 6 muaj bazë laboratorike*
Vendi kryesor i kërkimit	
Burimet financiare dhe kostot kryesore	*Grante, vetëfinancim, burime të tjera*
Mobilitet i parashikuar	*Nëse planifikohet periudhë kërkimi në një IAL tjetër (Kodi i Cilësisë, Shtojca 6, Standardi III.5, Kriteri 3: shkëmbim së paku 3-mujor me universitet nga BE, OECD ose G20); përndryshe "N/A"*

SEKSIONI 6 • PLATFORMA E DISERTACIONIT DHE PLANI I PUNËS

6.1 Platforma e disertacionit

Disertacioni hartohet sipas Rregullores

Nr.	Kapitulli	Përmbajtja / objektivi që mbulon
1	Hyrje	
2	Rishikimi i literaturës	
3	Qëllimi, objektivat, hipotezat	
4	Materiali dhe metodat	
5	Rezultatet	
6	Diskutimi	
7	Përfundime dhe rekomandime	
	Bibliografia; Shtojcat	

6.2 Plani i punës i ndarë në vite

Viti / periudha	Aktivitetet kryesore kërkimore dhe formuese	Rezultati / produkti i pritshëm (milestone)	Afati
Viti I	*p.sh. rishikim sistematik i literaturës; finalizim i protokollit; aplikim në Këshillin e Etikës të UMT-së; p.sh. studim pilot; validim instrumentesh; fillim i mbledhjes së të dhënave*		
Viti II	*p.sh. mbledhja kryesore e të dhënave / eksperimentet; analiza paraprake; referim i parë shkencor*		

Viti / periudha	Aktivitetet kryesore kërkimore dhe formuese	Rezultati / produkti i pritshëm (milestone)	Afati
Viti III	*p.sh. analiza përfundimtare; botime; hartimi i disertacionit; paraqitja në njësinë bazë*		
Viti IV–V (nëse aplikohet)	*Vetëm nëse planifikohet kohëzgjatje mbi 3 vite (max 5 vite, nenë 15)*		

6.3 Plani i përmbushjes së detyrimeve para mbrojtjes

Detyrimi	Kërkesa minimale	Plani (revista / veprimtaria, viti)
Referime / paraqitje shkencore	3, si autor i parë ose i dytë (kur i pari është udhëheqësi); 2 prej tyre në veprimtari ndërkombëtare në BE/OECD/G-20, të botuara në proceedings me ISBN/ISSN	
Artikull në revistë JCR ose Scopus	1, botuar ose pranuar për botim, të paktën autor i dytë	
Artikuj si autor i parë	2, në revista brenda vendit (të njohura nga UMT) ose ndërkombëtare të indeksuara	
Disertacioni	Sipas formatit të nenit 23 të Rregullores; kontroll antiplagjiaturë sipas VKM nr. 777/2018, me ngjashmëri nën 30 %; dosja depozitohet jo më herët se 3 vite nga regjistrimi	

SEKSIONI 7 • ETIKA, INTEGRITETI DHE PRONËSIA INTELEKTUALE

Plani i menaxhimit të të dhënave	*Ku ruhen të dhënat, si mbrohen të dhënat personale, kush ka akses dhe për sa kohë ruhen*
Miratimi nga Këshilli i Etikës i UMT-së	☐ *Kërkohet aplikimi brenda 2 muajve nga regjistrimi*
Çështje etike specifike	*Subjekte njerëzore, pëlqim i informuar, të dhëna personale, materiale biologjike, kafshë laboratorike*

Palët deklarojnë se njohin dhe do të zbatojnë rregullat e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor; udhëheqësi e ka vetëdijësuar doktorantin për rrezikun e fabrikimit, falsifikimit dhe plagjiaturës

SEKSIONI 8 • MONITORIMI DHE ANGAZHIMET E PALËVE

8.1 Monitorimi i ecurisë

Takimet doktorant–udhëheqës	*Frekuenca e rënë dakord: ☐ javore ☐ dyjavore ☐ mujore ☐ tjetër _____. Takimet janë zyrtare dhe të dokumentuara*
Raporti vjetor i ecurisë	*Paraqitet të paktën një herë në vit në njësinë bazë, me miratimin e udhëheqësit*
Treguesit e ecurisë për vitin e parë	*p.sh. protokolli final; miratimi etik; rishikimi i literaturës; studimi pilot etj*
Përditësimi i projektit	*Udhëheqësi jep konkluzionet e vlerësimit dhe, në bazë të ecurisë, miraton planin e veprimtarive në vijim. Ndryshimet nënshkruhen nga të dyja palët dhe i bashkëlidhen këtij projekti.*
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	*Në rast problemesh në udhëheqje, palët i drejtohen koordinatorit të programit dhe njësisë bazë. Vijimësia e udhëheqjes në rast zëvendësimi garantohet sipas legjislacionit në fuqi*

8.2 Angazhimet e doktorantit

- të njohë dhe zbatojë Rregulloren dhe bazën ligjore për doktoratat;
- të kompletojë programin e miratuar të kërkimit sipas këtij projekti dhe planit në vite;
- të raportojë të paktën një herë në vit në njësinë bazë mbi ecurinë e punës;
- të zbatojë standardet shkencore dhe etike dhe të shlyejë në kohë detyrimet financiare;
- të përfundojë punimin brenda afateve.

8.3 Angazhimet e udhëheqësit shkencor

- të zbatojë rregullat shkencore dhe etike dhe të sigurojë udhëheqjen brenda kohës së parashikuar;
- të japë mbështetjen akademike për platformën, literaturën dhe ndjekjen e protokollit të miratuar;
- të vlerësojë rregullisht progresin e doktorantit dhe të ndërmarrë veprime mbështetëse kur nevojitet;
- të ndihmojë në përgatitjen e referimeve dhe të nxisë botimin e rezultateve;
- të përfshijë doktorantin në veprimtari kërkimore dhe në mësimdhënie;

SEKSIONI 9 • NËNSHKRIMET

Palët konfirmojnë se ky është projekti përfundimtar i kërkimit shkencor të doktoratës, i rënë dakord ndërmjet tyre dhe në përputhje me projekt-propozimin fitues, Rregulloren "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave" i përditësuar dhe Udhëzimin e Rektorit nr. 6, datë 25.11.2026. Çdo ndryshim i temës ose i udhëheqësit bëhet vetëm sipas përcaktimeve ne rregulloren e organizimit të doktoratave në fuqi.

Doktoranti/ja		**Udhëheqësi shkencor**
_____ (emër, mbiemër, nënshkrim) Datë: ___ / ___ / 20___		_____ (emër, mbiemër, nënshkrim) Datë: ___ / ___ / 20___

Koordinatori i programit
Drejtuesi i njësisë bazë — mori dijeni

_____
(emër, mbiemër, nënshkrim)
Datë: ___ / ___ / 2026___

Përgjegjësi i programeve të doktoratës
Zv.Dekani për kërkimin shkencor — mori dijeni

_____
(emër, mbiemër, nënshkrim)
Datë: ___ / ___ / 2026__

Bashkëlidhur: projekt-propozimi fitues; CV akademike e udhëheqësit; vendimi i Këshillit të Etikës (kur ka marrë).

Shtojca nr. 8

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I _____
LISTA EMËRORE E DOKTORANTËVE TË REGJISTRUAR NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË", PËR PAJISJEN ME NUMËR MATRIKULLIMI (NIM)
VITI AKADEMIK 2026-2027

Nr.	Universiteti	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i studimit (fusha/nënfusha)	Data e regjistrimit (dd.mm.yyyy)	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindja (dd.mm.yyyy)	Gjinia M/F	Vendlindja	Numri personal i identitetit	Lloji i dokumentit të identifikimit	Emri i IAL-së paraardhëse	Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve	Nr. dhe data e diplomës pararendëse	Gjuha e huaj, niveli (min. B2) dhe dëshmia	Tema e projektit kërkimor të doktorantit	Udhëheqës Shkencor*
1	UMT																		
2	UMT																		
3	UMT																		
4	UMT																		

Shënim: bashkëlidhur për çdo doktorant kërkohet:
1. kopje e dëshmisë së gjuhes se huaj,
2. kopje e të gjitha diplomave paraardhëse të studentit (nëse IAL nuk është UMT)

2. NIM-i caktohet sipas Udhëzimit të MASR nr. 16, datë 08.07.2019, dhe Rregullores së doktoratave, neni 6, pika 8.
*) Udhëheqësi shkencor sipas listës së miratuar me VSA nr. 84, datë 31.07.2026.